# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-474478**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Investimet e huaja ndryshojnë hartën e Shqipërisë/ Kryeson Austria, pronat thithin mbi 600 milionë euro |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/27/investimet-e-huaja-ndryshojne-harten-e-shqiperise-kryeson-austria-pronat-thithin-mbi-600-milione-euro/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 17:54:45 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 27 shtator 2026, 17:48:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 27 shtator 2026, 17:47:00 UTC → 27 shtator 2026, 17:49:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `179e61cde1c20958f7a82aa10788755908935f609ba3a798bf78b8fb755f9696` |
| TEKSTI | `a497e6c5e56e8d76fadd6a131c8150111e632613ff2189160ebc29b0ba510b8f` |
| PAMJA | `ee50bfb560270261d8e0093b199e7753934996b50f187d944e46d52f2316e467` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `db1293b8518bf81add63f2dd65d106b767ff85ee0eefb93a9b0a4481ddfa0d0f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b1c7a27947b4cc546e59bf39e541eaf49f294f8d53ee0afce777d7f589624631` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/db1293b8518bf81add63f2dd65d106b767ff85ee0eefb93a9b0a4481ddfa0d0f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

EKONOMI TË FUNDIT

# Investimet e huaja ndryshojnë hartën e Shqipërisë/ Kryeson Austria, pronat thithin mbi 600 milionë euro

27/09/2026 19:48




**Paratë e huaja po ndryshojnë hartën e investimeve në Shqipëri.**

Në gjysmën e parë të këtij viti, Austria ka kaluar në krye të listës së investitorëve të huaj ndërsa pas tyre vijnë Turqia dhe Italia. Por përtej vendeve nga vijnë paratë, ajo që bie më shumë në sy është se ku po investohen ato.

Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë për 6-mujorin e parë të vitit investimet e kompanive me kapital austriak arritën vlerën e 122 milionë eurove, në rritje me 79% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Investimet austriake në Shqipëri janë të përqendruara sidomos në tregun e sigurimeve, në sektorin energjetik dhe në shërbimet e hotelerisë.

Pas Austrisë renditet Turqia, me 111 milionë euro investime në gjashtë muaj.

Kompanitë turke po investojnë më shumë në sektorin financiar, energjetik, industrinë nxjerrëse dhe ndërtim. Italia vijon me një fluks total prej 99 milionë eurosh, ndërsa Holanda ka zbritur në vendin e katërt.

Holanda është një nga vendet e preferuara në Europë për regjistrimin e kompanive mëmë, përmes të cilave mund të kontrollohen investime ndërkombëtare në kompani të ndryshme.

Kapitali i huaj po hyn në Shqipëri, por zgjedhjet e investitorëve tregojnë edhe se cilat fusha po shihen sot si më tërheqëse.

Nga 1.14 miliardë euro investime të huaja, 609.6 milionë euro janë investuar në pasuri të paluajtshme. Në këtë sector rritja krahasuar me një vit më parë është mbi 140%.

Në vend të dytë renditen aktivitetet financiare dhe të sigurimit, ndërsa rritje është regjistruar edhe në industrinë përpunuese, si dhe në informacion dhe komunikacion.

Edhe ndërtimi ka shënuar një rritje të fortë. Investimet në këtë sektor pothuajse u trefishuan.

Por jo të gjithë sektorët kanë marrë më shumë kapital të huaj.

Industria nxjerrëse shënoi një tkurrje të fortë. Investimet ranë nga 97.2 milionë euro në 27.6 milionë euro. Rënie pati edhe transporti dhe magazinimi, ndërsa akomodimi dhe shërbimi ushqimor.

Ndërsa prona dhe ndërtimi po marrin gjithnjë e më shumë vëmendje, rënia në sektorët e tjerë tregon se fluksi i investimeve nuk po shpërndahet njësoj në të gjithë ekonominë.

INVESTIMET E HUAJA NË SHQIPËRI NGA AUSTRIA

6-mujori 0.122 mld euro
Stoku 1.39 mld euro

INVESTIMET E HUAJA SIPAS SHTETEVE, 6 MUJORI
(Burimi: Banka e Shqipërisë)

Austri 122 mln euro
Turqi 111 mln euro
Itali 99 mln euro
Holandë 89 mln euro


## Kryesore



Ekskluzive/ Ministri Ferit Hoxha avancon me rokadën e ambasadorëve, Denion Meidani shkon në Prishtinë, Petrit Malaj në Shkup
19:40

"Fiks Fare" gati për sezonin e ri/ Provat e fundit në studion e re, Olta Gixhari dhe Dorian Ramaliu gati për premierën më 28 shtator
12:53

Atentati në Athinë, 25 plumba në kafene/ Ja çfarë i tha Denis Luli kamarierit para sulmit
13:07

Theu xhamin e supermarketit dhe vodhi kasën me para, arrestohet 32-vjeçari në Vlorë
14:10

Pas fitores me Bjellorusinë, kombëtarja përgatitet për San Marinon, historiku i përballjeve mes tyre
11:39

## Më të lexuarat

Thirrja urgjente/ Rama mesazh shqiptareve nga Rinasi direkt pas kthimit nga SHBA, zbardhen detajet

Kryeministri Rama mbërrin nga New York në orën 13:00, burime qeveritare tregojnë për Top Channel çfarë pritet të deklarojë nga salla VIP në Rinas

"Jeni rrezik për sigurinë kombëtare"/ Azgan Haklaj dhe Ferdinand Samarxhiu ndalohen në kufi me Maqedoninë e Veriut

Atentati në Athinë, 25 plumba në kafene/ Ja çfarë i tha Denis Luli kamarierit para sulmit

Kryeministri Rama mbërrin në aeroportin e Rinasit, pritet deklarata e paralajmëruar

E PLOTË/ "Si ka mundësi që nuk e dija?", mesazhi i Ramës pas akuzave të SPAK për zyrtarët pranë tij: Kam fajet e mia, por jam këtu për të bërë histori e jo pasuri

Aksident tragjik në Maliq/ Nuk kapi frenat e dorës, makina rrëshqet dhe e zë poshtë, humb jetën 44-vjeçari

Çfarë e shkaktoi shpërthimin?/ Tragjedia në familjen shqiptare që humbi 4 anëtarë gjatë pushimeve në Greqi, mbërrijnë në Athinë të afërmit e viktimave

Lavrov për S-400: Rusia mund të lejojë transferimin nga Turqia, por vendos kushte

Kapiteni bjellorus pranon skandalin në fushë: E shava arbitrin! Atmosfera e tifozëve shqiptarë? Ishte çmenduri

Holandë 89 mln euro

INVESTIMET NË PASURI TË PALUAJTSHME
(Burimi: Banka e Shqipërisë)

Totali 1.14 mld euro
Prona 0.609 mld euro

INVESTIMET E HUAJA NË SEKTOR TË NDRYSHËM

Prona 609 mln euro
Akt. Financiare 180.9 mln euro
Industri përpunuese 92 mln euro
Informacion/komunikacion 47.3 mln euro

SEKTORËT ME RËNIE TË INVESTIMEVE TË HUAJA
(Burimi: Banka e Shqipërisë)

Ind. Nxjerrëse -71.6%
Transport/magazinimi -31.5%
Akomodimi -27.1%

**Top Channel**

## Ekonomi »



**Sezoni i patates në Stëblevë/ Fshati që prodhon deri në 10 mijë tonë, fermerët: Jetojmë vetëm me këtë produkt**
27/09 12:37



**Fasoneritë kërkojnë ndihmë/ Europa e dobët dhe kostot në rritje, prodhuesit duan ndryshime fiskale për 2027**
26/09 12:12



**Turizmi ngadalësoi në gusht, në tetë muaj regjistrohen 9.4 milionë hyrje të huajsh, 5.3% më shumë se në 2025**
25/09 15:22



**Të huajt marrin më pak prona, blerjet nga jo-rezidentët bien nga 25% në 20%, rriten investimet e huaja**
24/09 20:21



**Çmimet e banesave frenojnë rritjen, por nuk ulen, duhen më shumë muaj për të shitur një apartament**
23/09 19:55



**Programi i strehimit, Ibrahimaj: Për çifte reja kredi e butë për apartamente deri në 200 mijë euro, kredi me 0% interes për...**
22/09 15:32

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



**Top Channel/ Rokadë ambasadorësh Denion Meidani shkon në Prishtinë, ndërsa Petrit Malaj në Shkup**



**Top Channel/ Rama: Vlora Hyseni të përballet me SPAK, përbaltja e SHISH, e papranueshme**



**Top News- "Çfarë po fsheh Rama", Bardhi reagon pas mesazhit të kryeministrit për Vlora Hysenin**









**Top News – Hartohen planet e evakuimit / Shtetet e NATO-s përgatiten për një sulm rus**



**Top News – Do godasë luftanijet në Oqeanin Indian/ Irani kërcënon Trump, hakmarrje nëse rinis sulmet**




**Top News – Makinë me eksploziv në bazën britanike / Përdorej nga SHBA për të bombarduar Iranin**

## Lajme

- Lajmet e fundit
- Politikë
- Kronikë
- Aktualitet
- Ekonomi
- Sociale
- Video
- Top News LIVE

## Bota

- Opinion
- Koment
- Kosova dhe Rajoni
- Shkencë dhe Teknologji
- Auto

## Sport

- Kombëtarja
- Kategoria Superiore
- Kategoria e Parë
- Premier League
- La Liga
- Serie A
- Shumësportësh
- Sport Gossip

## Pop News

- Showbiz
- Lifestyle
- Fashion
- Shëndeti
- Dieta
- Receta gatimi

## Programe

- Big Brother VIP
- Për'puthen
- Shqipëria LIVE
- Fiks Fare
- Video
- Të gjitha programet
- Guida TV

## Top Channel

- Rreth Top Channel
- Kontakt
- Bileta – Portokalli
- Puno në Top Channel
- Privacy Policy & Terms of Use
- Aksesueshmëria

**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.